LIGJ
Nr.7720, datë 14.6.1993

PËR KONTROLLIN DHE DISIPLINIMIN E NDËRTIMEVE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Projektimi, drejtimi, zbatimi dhe kolaudimi i punimeve për objektet në Republikën e Shqipërisë kontrollohet dhe disiplinohet në bazë të dispozitave të këtij ligji.

Neni 2

Ligji zbatohet për të gjitha projektimet dhe zbatimet e punimeve ndërtimore që realizohen nga persona fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 3

Në kuptim të këtij ligji, nëse nuk përcaktohet ndryshe:

a) ndërtime prej murature janë strukturat ndërtimore prej muri që kryejnë një funksion statik;

b) ndërtime prej betoni e betonarmeje të zakonshme janë strukturat ndërtimore që përbëhen nga një kompleks strukturash prej betoni, betonime e armatura metalike dhe që kryejnë një funksion statik;

c) ndërtime prej betonarmeje të paranderur janë strukturat ndërtimore të përbëra nga betoni me armaturë metalike të paranderur, që kryejnë një funksion statik;

ç) ndërtime metalike janë struktura ndërtimore, të përbëra tërësisht ose pjesërisht nga elementë çeliku ose metale të tjera, që kryejnë një funksion statik;

d) ndërtime me materiale të tjera ose kombinime të tyre janë strukturat ndërtimore që kryejnë një funksion statik;

e) objekt është ai kombinim strukturash ndërtimore që në tërësinë e tyre kompletojnë qëllimin për të cilin janë kombinuar.

Neni 4

Ndërtimet e përcaktuara në nenin 3 duhet të zbatohen në mënyrë të tillë që të sigurohet qëndrueshmëria e tyre dhe të mënjanojnë çfardolloj rreziku për sigurinë shoqërore.

KREU II
PROJEKTIMI, DREJTIMI DHE ZBATIMI I PUNIMEVE

Neni 5

Objektet e përkufizuara në nenin 3 të këtij ligji zbatohen në bazë të një projektzbatimi të hartuar nga një organ projektues shtetëror ose nga persona fizikë a juridikë, vendas ose të huaj, të

pajisur me licencën përkatëse.

Neni 6

Zbatimi i punimeve kryhet nga ndërmarrjet shtetërore ose nga personat fizikë a juridikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencë përkatëse për zbatim punimesh ndërtimore. Drejtuesi i punimeve, i emëruar nga investitori, duhet të jetë inxhinier, arkitekt ose teknik ndërtimi i pajisur me licencë përkatëse. Në rastet kur gjykohet nga investitori, në rolin e drejtuesit të punimeve mund të caktohet zbatuesi i punimeve ose vetë investitori.

Neni 7

Projektuesi ka përgjegjësi për projektimin e objektit që duhet të projektohet në përputhje me kushtet teknike në fuqi.

Drejtuesi i punimeve dhe zbatuesi, sipas përkatësisë, kanë përgjegjësinë e ndërtimit të objektit në përputhje me projektin dhe kushtet teknike në fuqi, të mbikqyrjes dhe përshkrimit të zbatimit të projektit, të cilësisë së materialeve të përdorura që plotësojnë kërkesat e objektit, si dhe për vendosjen në vepër të elementeve të parapërgatitura.

Neni 8

Për të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 zbatuesi i punimeve duhet të njoftojë në seksionin e urbanistikës në rreth përpara fillimit të punimeve.

Në këtë njoftim duhet të shënohen emrat dhe të dhënat e investitorit, të projektuesit, drejtuesit të punimeve dhe zbatuesit.

Me këtë njoftim duhet të bashkëlidhen:

a) Projektzbatimi në dy kopje, i firmosur nga projektuesi dhe i shoqëruar me llogaritjet përkatëse, plani i vendosjes dhe leja e ndërtimit.

b) Në relacion përshkrues në dy kopje, të firmosur nga projektuesi ku të shprehen karakteristikat dhe cilësia e materialeve që do të përdoren.

Seksioni duhet t'i kthejë zbtuesit një kopje të projektit dhe relacionit me konfirmimin përkatës të aktit të depozitimit.

Edhe në raste ndryshimesh thelbësore të projektit, gjatë zbatimit, duhet të respektohet e njëjta procedurë.

Neni 9

Në kantiere, nga dita e fillimit të punimeve deri në përfundimin e tyre, duhet të ruhen aktet e përshkruara në shkronjat "a" dhe "b" të nenit 8, të firmosura e datuara nga zbatuesi dhe drejtuesi i punimeve, si dhe një libër kantieri.

Për saktësinë e mbajtjes së këtyre dokumenteve është përgjegjës drejtuesi i punimeve, i cili gjithashtu është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore librin e kantierit.

Neni 10

Me përfundimin e ndërtimit, brenda 30 ditëve, drejtuesi i punimeve depoziton në seksionin e urbanistikës në rreth një relacion në dy kopje rreth plotësimit të detyrimeve që rrjedhin nga neni 8, duke paraqitur:

a) Çertifikatat e provave të materialeve të përdorura, lëshuar nga laboratorët e autorizuar sipas nenit 25 të këtij ligji.

b) Për ndërtimet e paranderura, çdo të dhënë për plotësime në vepër të kësaj strukture.

c) Përfundimet e provave eventuale të ngarkesës, duke bashkëlidhur aktet e mbajtura.

ç) Objekti është zbatuar në përputhje me projektzbatimin.

Njëra nga dy kopjet e këtij relacioni ruhet në seksionin e urbanistikës në rreth, tjetra merret e konfirmuar për depozitimin dhe nga drejtuesi i punimeve dërgohet te kolaudatori, duke bashkëlidhur

dokumentet sipas nenit 8 të këtij ligji.

Neni 11

Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit teknik-ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë:

1. Objekti është realzuar në përputhje me projektin dhe me kushtet teknike.
2. Objekti është realizuar në përputhje me kontratën.
3. Të dhënat nga matjet dhe dokumentet përputhen në dimension, formë, sasi e cilësi.
4. Çmimet e aplikuara janë në përputhje me kontratën.
5. Në këtë akt ekzaminohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve.

Kolaudimi duhet të kryhet nga një inxhinier ose arkitekt i pajisur me licencë përkatëse projektimi e zbatimi dhe që të mos jetë e lidhur në asnjë mënyrë me projektimin, drejtimin e zbatimin e ndërtimit që do të kolaudojë.

Emërimi i kolaudatorit apo grupit të kolaudimit është detyrë e investitorit, i cili duhet që këtë t'ia komunikojë seksionit të urbanistikës në rreth brenda 30 ditëve nga përfundimi i punimeve. Investitori do të përcaktojë edhe afatet e zgjatjes së procesit të kolaudimit.

Kur nuk ka investitor dhe ndërtuesi ndërton për llogari të tij, ky i fundit është i detyruar të kërkojë po brenda 30 ditëve nga seksioni i urbanistikës një listë me disa emra kolaudatorësh, sipas paragrafit 2 të këtij neni, dhe ai do të zgjedhë njërin prej tyre.

Procesverbali i kolaudimit duhet të përmbajë:

- Vendin e ndërtimit,
- Emërtimin e objektit dhe funksionin e tij,
- Datën dhe prejardhjen e projekteve si dhe ndryshimet në të,
- Vlera e objektit,
- Gjeneralitetet e zbatuesit,
- Afati i ndërtimit,
- Shuma e shpenzimeve,
- Gjeneralitetet e kolaudatorit apo grupit të kolaudimit dhe specialiteti përkatës,
- Koha e zgjatjes së kolaudimit,
- Përshkrimi i verifikimeve të bëra mbi dokumentet dhe faktin, si dhe rezultatet e arritura.

Procesverbali firmoset nga kolaudatori, zbatuesi, si dhe drejtuesi i punimeve.

Kolaudatori paraqet në dy kopje procesverbalin e kolaudimit në zyrën e urbanistikës, ku pas regjistrimit ia dërgon investitorit.

Neni 12

Dhënia e lejes së shfrytëzimit ose të banimit bëhet nga seksioni i urbanistikës pas depozitimit të procesverbalit të kolaudimit.

Neni 13

Personat juridikë që prodhojnë betone, llaçe, parafabrikate të zakonshme e të paranderura, si dhe konstruksione metalike kanë detyrim t'i dërgojnë Ministrisë së Ndërtimit, të Strehimit dhe Rregullimit të Territorit një relacion të veçantë, në të cilin duhet:

a) të përshkruhet secili tip strukture, së bashku me llogaritjet statike;

b) të saktësohen karakteristikat e materialeve që përdoren, të mbështetura mbi provat e kryera pranë laboratorëve, sipas nenit 25 të këtij ligji.

Neni 14

Të gjitha elementet e paranderura duhet të kenë shenjën dalluese të prodhimit, të dukshme dhe të qëndrueshme në kohë.

KREU III
KONTROLLI

Neni 15

Kryetari i këshillit të rrethit, në territorin e të cilit realizohen ndërtimet e përkufizuara në nenin 3, duhet të kontrollojë respektimin e dispozitave të këtij ligji me anë të seksionit të urbanistikës në rreth ose personave të tjerë të autorizuar prej tij.

Neni 16

Personat e përcaktuar në nenin 15, kur vërejnë shkelje të dispozitave të këtij ligji, mbajnë procesverbale të konstatimit të kundërvajtjeve administrative, të shkeljeve ligjore dhe zbatojnë sanksionet e parashikuara në këtë ligj.

Neni 17

Kryetari i këshillit të rrethit, pasi ka marrë procesverbalin dhe pasi ka verifikuar gjendjen, urdhëron investitorin, drejtuesin e punimeve dhe zbatuesin për pezullimin e punimeve.

Punimet nuk mund të rifillojnë derisa seksioni i urbanistikës nuk ka verifikuar plotësimin në rregull të të gjitha mangësive të vërejtura sipas dispozitave të këtij ligji.

KREU IV
SANKSIONE

Neni 18

Projektimi, drejtimi dhe zbatimi i objekteve të përkufizuara në nenin 3 të këtij ligji apo edhe pjesë të tyre në kundërshtim me nenin 5 e 6, kur nuk përbëjnë vepër penale, dënohen me gjobë nga 10.000 lekë deri në 100.000 lekë.

Neni 19

Zbatuesi, kur nuk kryen detyrimet e parashikuara në nenin 8, dënohet me gjobë nga 10.000 deri në 100.000 lekë.

Neni 20

Drejtuesi i punimeve, që nuk plotëson detyrimet e parashikuara në nenin 7 dënohet me gjobë nga 1.000 lekë deri në 10.000 lekë.

Neni 21

Kolaudatori që nuk zbaton dispozitat e nenit 11 për paraqitjen e dokumenteve në rreth, dënohet me gjobë nga 1.000 lekë deri në 10.000 lekë.

Neni 22

Lejimi i përdorimit të ndërtimit pa procesverbalin e kolaudimit, dënohet me gjobë nga 10.000 lekë deri në 100.000 lekë.

Neni 23

Kundër vendimit të dënimit, mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve nga data e shpalljes ose e njoftimit, në gjykatën e rrethit ku është kryer kundërvajtja, vendimi i të cilës është i formës së prerë.

KREU V
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 24

Për efekt të këtij ligji quhen laboratorë zyrtarë:

- Laboratorët e ISTN.
- Laboratorët e fakulteteve të inxhinierisë së Universitetit të Tiranës.
- Laboratorët e tjerë të përcaktuar nga Ministria e Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit.

Neni 25

Të gjitha dispozitat që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 26

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.590, datë 2.7.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.